

VENDIM
Nr. 129, datë 17.2.2016

**PËR SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E BASHKIVE, PËR VITIN 2016, PËR
PASTRIMIN E KANALEVE UJITËSE DHE KULLUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e bashkive, të miratuar për vitin 2016, të shtohet fondi prej 111 000 000 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë) lekësh, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky fond i shtohet transfertës specifike sipas bashkive, të miratuar për vitin 2016, për funksionin e ujitjes e të kullimit.

2. Ky fond të përdoret për pastrimin me ekskavatorë të kanaleve ujitëse dhe kulluese, të transferuar në pronësi të bashkive.

3. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

4. Ngarkohen ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, ministri i Financave dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1. Fondi i shpenzimeve për pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese sipas bashkive

Qarku	Bashkia	Vlera në lekë
Qarku Fier	Fier	20,000,000
Qarku Fier	Lushnjë	15,000,000
Qarku Fier	Divjakë	10,000,000
Qarku Korçë	Maliq	6,000,000
Qarku Korçë	Korçë	10,000,000
Qarku Lezhë	Lezhë	10,000,000
Qarku Lezhë	Kurbini	6,000,000
Qarku Durrës	Durrës	10,000,000
Qarku Shkodër	Shkodër	6,000,000
Qarku Vlorë	Vlorë	6,000,000
Qarku Berat	Berat	6,000,000
Qarku Tiranë	Kavajë	6,000,000
TOTALI		111,000,000